REZOLUTË
Datë 20.11.2006

PËR PROJEKTIN NAFTËSJELLËS "AMBO"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke e konsideruar projektin "Ambo" si një ndër projektet gjeostrategjike më të rëndësishme të vendit, vlerëson se mbështetja e tij nga institucionet shqiptare duhet të qëndrojë përtej dallimeve politike.

Të tre shtetet ku kalon naftësjellësi "Ambo", Bullgaria, Maqedonia dhe Shqipëria, kanë shprehur secili veç e veç, si edhe në takime të përbashkëta, vullnetin e tyre për ndërtimin e kësaj vepre.

Të tre qeveritë ku kalon naftësjellësi, Bullgaria, Maqedonia dhe Shqipëria, kanë nënshkruar tashmë marrëveshjet zyrtare për ndërtimin e tij.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se projekti "Ambo":

Është një investim strategjik në fushën e energjisë, rëndësia e të cilit në aspektin kombëtar, rajonal dhe global sa vjen e rritet;

Është projekt i suportuar nga Qeveria e SHBA-së, që rrit rëndësinë strategjike të tij dhe rivlerëson pozitivisht partneritetin strategjik të Shqipërisë me SHBA-në;

Vlerëson dhe prezanton potencialet në rritje që ofron pozicioni gjeografik i vendit, duke dhënë garanci për projekte të tjera, që Shqipëria të jetë porta e Ballkanit Perëndimor;

Do të ndikojë në modernizimin e Portit të Vlorës;

Gjatë periudhës së ndërtimit të tij do të hapen rreth 2000-3000 vende pune;

Pasi të fillojë funksionimi i naftësjellësit, do të krijohen vende të konsiderueshme pune të përhershme për naftësjellësin dhe terminalin e tij në Vlorë;

Do të shoqërohet me zhvillimin e sferës së shërbimeve, të cilat do të jenë të lidhura me punën në naftësjellës;

Do të sjellë të ardhura në Buxhetin e Shtetit prej rreth 30 milionë USD në vit;

Do të shoqërohet me ngritjen e një sërë veprimtarish të tjera ekonomike përgjatë trasesë së tij;

Do të ndikojë në rritjen e rolit dhe prestigjit të Shqipërisë në nivel rajonal.

Kuvendi i Shqipërisë, nisur nga rëndësia e veçantë e projektit "Ambo", i kërkon Qeverisë:

Të vazhdojë angazhimin e saj për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e nënshkruar për ndërtimin e naftësjellësit;

Të përshkallëzojë hapat diplomatikë me vendet e tjera që preken nga projekti, me qëllim përshpejtimin e procedurave ndërshtetërore të projektit;

Të marrë të gjitha masat, nëpërmjet organizmave shtetërore, për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në funksion të projektit;

Të informojë dhe të sqarojë opinionin e gjerë shqiptar për rëndësinë e projektit dhe përfitimet që do të kenë komunitetet që preken drejtpërdrejt nga projekti, si dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi;

Të investojë në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për të përcaktuar dhe kontrolluar normativat që duhet të përmbushen për të mbajtur projektin brenda normave kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit dhe të deklarohet radhë pas radhe për situatën e respektimit të tyre.